



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA VI

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Integritet Evropian

Mbledhja nr. 4.

Prishtinë, më 24.10.2017, në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla S-225

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR INTEGRITET EVROPIANE

Në mbledhje morën pjesë: Blerta Deliu -Kodra, Zenun Pajaziti, Armend Zemaj, Ilir Deda, Ahmet Isufi, Fikrim Damka, Milaim Zeka dhe Adem Hoxha!

Munguan: Driton Çausi, Fitore Pacolli dhe Glauk Konjufca.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Adelina Demolli, Ahtere Loxha, Safet Beqiri, dhe Florent Mehmeti.

I ftuar: ministri i Drejtësisë, z. Abelard Tahiri.

Pjesëmarrësit e tjerë: përfaqësuesit nga GLPS, GIZ, OSBE-së, Zyra e Komisionit Evropian në Kosovë, NDI, KDI dhe mediat.

Mbledhjen e kryesoi znj. Blerta Deliu- Kodra – kryetare e komisionit.

Kryetarja-Blerta Deliu- Kodra pasi konstatoi se janë plotësuar kushtet për punë e hapi mbledhjen e Komisionit me këtë;

Rend të ditës:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Raportim i z. Abelard Tahiri, ministër i Drejtësisë, lidhur me përmbushjen e obligimeve në kuadër të agjendës evropiane;**
- 3. Të ndryshme.**

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Raportim i z. Abelard Tahiri, ministër i Drejtësisë, lidhur me përmbushjen e obligimeve në kuadër të agjendës evropiane

Kryetarja falënderoi ministrin që i është përgjigjur ftesës për të raportuar para Komisionit.

Ajo theksoi se duke pasur parasysh se sektori i sundimit të ligjit paraqet një nga sfidat kryesore për Kosovën, ju kemi ftuar që fillimisht të marrim informata se cilat janë të arriturat, mangësitë dhe sfidat me të cilat ballafaqoheni në këtë sektor.

Në tekstin e MSA-së, përcaktohet që palët në këtë marrëveshje, në fushën e lirisë, sigurisë dhe drejtësisë t'i kushtojnë rëndësi të veçantë konsolidimit të sundimit të ligjit, pra kjo nënkupton një fuqizim të Institucioneve dhe efikasitet të organeve që merren me zbatimin e ligjit dhe jo vetëm.

Prandaj, në këtë kontest, sundimi i ligjit mbetet prioriteti kryesor i institucioneve tona, ku kërkohet një angazhim maksimal.

Një rëndësi të veçantë për ne ka, po ashtu, edhe procesi i liberalizimit të vizave, ku një ndër kriteret e mbetura për plotësim është edhe luftimi i korrupsionit dhe krimit të organizuar, andaj dëshiroj të di më shumë edhe lidhur me përmbushjen të këtij kriteri.

Ministri Abelard Tahiri fillimisht theksoi që Ministria e Drejtësisë, në kuadër të kompetencave të saj është duke punuar vazhdimisht në avancimin e legjislacionit penal, kundër korrupsionit dhe atë të reformave gjyqësore, në kuadër të sfidave të dala nga Agjenda Evropiane në vend, e në veçanti përmbushjes së agjendës evropiane të reformave (ERA). Kur jemi te Agjenda Evropiane e Reformave, Ministria e Drejtësisë ka tri prioritetet që dalin nga ky proces. Andaj, shfrytëzojmë rastin që t'ju njoftojmë për statusin e përmbushjes së këtyre tre prioritetëve.

1. Koncept dokumenti mbi plotësimin-ndryshimin e legjislacionit në fuqi për të siguruar pezullimin ose largimin e detyrueshëm të zyrtarëve publikë të akuzuar apo dënuar për korrupsion. MD e ka dërguar në konsultime paraprake draftin e Koncept- dokumentit për pezullim, apo largim nga puna të zyrtarëve të akuzuar për vepra penale të korrupsionit, drafti i është dërguar për konsultime përfaqësuesve nga institucionet përkatëse nga Sektori i Drejtësisë, përfaqësuesve të shoqërisë civile që kanë marrë pjesë edhe në grup punues, përfaqësuesve të Zyrës së BE-së, Ambasadës Amerikane, etj. Pas kësaj, ne kemi pranuar disa komente nga gjyqësori dhe prokuroria dhe tash jemi në fazën e diskutimeve për përfshirjen e tyre në draftin final, i cili shumë shpejt do të dërgohet për konsultime edhe me publikun, pastaj do të përcillet në Qeveri për miratim.

Sipas opsionit të rekomanduar në Koncept- Dokumentin përkatës, synohet që përmes ndryshim plotësimi të Kodit Penal dhe Kodit të Procedurës Penale, në momentin e ngritjes së aktakuzës për veprat penale që ndërlidhen me vepra korruptuese, apo keqpërdorim të pozitës apo autoritetit zyrtar. Zyrtarët publik do të pezullohen nga puna deri në përfundimin e procesit gjyqësor. Këto dispozita të reja ligjore do t'u mundësonin gjykatave për të pezulluar përkohësisht zyrtarët publikë nga pozita e tyre, në qoftë se ekziston mundësia që ata do të dënohen me një vendim të plotfuqishëm që shpie në largimin përfundimtar nga pozitat e tyre, ose edhe në rastet kur gjykata

konsideron që prania e këtyre zyrtarëve publikë, në vendin e punës, do të mund të dëmtojë hetimet.

2. Projektligjin për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik - Siç jeni në dijeni ky Projektligj ishte miratuar nga legjislatura e kaluar në lexim të parë, por për shkak të rrethanave politike i njëjti është kthyer në MD. Mirëpo, të njëjtin version e kemi ri-proceduar dhe miratuar në Mbledhjen e Qeverisë dhe tani i njëjti gjendet në Kuvend. Projektligji është në tërësi në harmoni me legjislacionin e BE-së.

3. Projektligjin për Prokurorin e shtetit, përkatësisht rishikimi i dispozitave që i referohen çështjes së emërimit të prokurorëve në Prokurorinë Speciale - Në bashkëpunim të ngushtë me përfaqësues nga Prokuroria e Shtetit, Zyra e BE-së dhe Ambasada Amerikane është përgatitur versioni i Projektligjit, i cili është dërguar për konsultime paraprake, dhe pas marrjes së komenteve eventuale i njëjti do të përcillet për konsultime me publikun, pastaj për miratim në Qeveri. Me këtë Projektligj do të rishikohen kriteret për emërimin e prokurorëve në Prokurorinë Speciale, marrë parasysh se konsiderohet, se kriteret aktuale për emërimin e prokurorëve në Prokurorinë Speciale janë të ashpra. Në vazhdim tha se kur jemi të **përbushja e obligimeve që rrjedhin nga PKZMSA**, mund të themi që rishikimi i legjislacionit penal dhe atij kundër-korrupsion është pjesë aktiviteteve intensive për vitin 2017 dhe 2018. Edhe pse Ministria e Drejtësisë ka kompetenca mjaft të kufizuara në drejtim të punës së prokurorisë edhe gjykatave, ne jemi të përkushtuar t'ju dalim në ndihmë me vendosjen e politikave më të mira për të funksionuar sistemi i sundimit të ligjit në vendin tonë. Lufta kundër korrupsionit, shpëlarjes së parave dhe financimit të luftimit të terrorizmit, është një proces i vështirë dhe sfidues.

MD ka marrë përgjegjësinë e koordinimit të institucioneve të drejtësisë me qëllim të realizimit të një sërë aktiviteteve që do të krijojnë parakushte për qasje më të lehtë në drejtësi. Gjithashtu, gjatë procesit të Rishikimit Funksional të Sektorit të Sundimit të Ligjit do të trajtojmë në mënyrë të veçantë kapacitetet institucionale të aktorëve që janë të përfshirë në luftën kundër korrupsionit me qëllim të zbatimit dhe bashkërendimit, si dhe forcimit edhe më tej të masave që do të ndërmerren kundër kësaj dukurie të shëmtuar.

MD ka themeluar vitin e kaluar Grupin Punues për **Procesin e rishikimit të legjislacionit penal** (Kodit Penal dhe Kodit të Procedurës Penale). Janë duke u mbajtur takime të shumta lidhur me këtë proces ku janë përfshirë, përveç zyrtarëve nga institucionet ndërkombëtare, (Zyra e BE-së, EULEX-i, Ambasada e ShBA-së në Kosovë, etj.) edhe gjyqtarë nga të gjitha nivelet e gjykatave, prokurorë, policë, avokatë, përfaqësues të shoqërisë civile, si dhe profesionist të tjerë të kësaj fushe. Krahas përpjekjeve për plotësim ndryshimin e Kodit Penal dhe Kodit të Procedurës Penale, si dhe **ligjeve kundër-korrupsion** është përgatitur dhe ka kaluar faza e konsultimeve edhe Koncept Dokumenti për fushën e Agjencisë Kundër Korrupsionit dhe për deklarin, prejardhjen e pasurisë, i cili së shpejti do të procedohet në Qeveri për miratim. Pastaj është hartuar drafti i Projektligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të

Gjyqtarëve dhe Prokurorëve. Në kuadër të mbrojtjes së të drejtave të njeriut, **në sistemin e burgjeve**, vazhdon respektimi i Standardeve Minimale të rregullave të OKB-së për trajtimin e të Burgosurve, si dhe Rregullave Evropiane të Burgjeve. MD është duke punuar për fuqizimin e njësisë ekonomike në kuadër të Shërbimit Korrektues të Kosovës, si dhe zgjedhjen e drejtorit të përgjithshëm të ShKK- së.

Kosova është duke u përgatitur për të pasur qasje në një numër konventash ndërkombëtare siç janë: Konventa e Hagës mbi zgjedhjen e marrëveshjes gjyqësore, Konventa mbi Ligjin e aplikueshëm për Kontratat për Shitjen Ndërkombëtare të Mallrave dhe Konventa mbi marrjen e provave jashtë shtetit në çështjet civile dhe tregtare.

Në **fushën e Mjekësisë Ligjore** MD ka filluar të hartojë Strategjinë për Fushën e Mjekësisë Ligjore, përmes të cilës do të trajtohen fusha të ndryshme, zhvillimi dhe avancimi i të cilave do t' i kontribuojnë drejtësisë. Vlen të theksohet që Ligji për Institutin e Mjekësisë Ligjore është aprovuar në Kuvend dhe tash ne jemi duke punuar në funksionalizimin e plotë të Institutit të Mjekësisë Ligjore. Unë jam i përkushtuar të përzgjidhen njerëzit adekuatë në krye të Institutit dhe se do të ketë prioritet punën për bartjen e kapaciteteve nga Departamenti i Mjekësisë Ligjore te vendorët. Organogrami parasheh rritjen e stafit të këtij Instituti për 10 persona, derisa do të vazhdojnë t'i shfrytëzojnë kapacitetet e EULEX-it tek ekspertët e antropologëve, deri në përfundimin e shkollimit të 2 ekspertëve të tillë, që po mundësohet nga Mbretëria e Bashkuar.

Në kuadër të **zbatimit të Ligjit për parandalimin dhe luftimin e trafikimit me njerëz** dhe mbrojtjen e viktimave të trafikimit, në bashkëpunim me të gjithë aktorët vendorë dhe ndërkombëtarë, këtu në veçanti mund të përmendim mbështetjen e afruar nga Ambasada e SHBA në Kosovë, është finalizuar lista e treguesve lidhur me trafikimin me njerëz, e cila është miratuar në Qeveri. MD, gjithashtu, ka hartuar dhe miratuar programin për kompensim të viktimave. MD në bashkëpunim me donatorët është duke ndërmarr aktivitetet për organizimin e trajnimeve për kompensimin e viktimave të krimit. Komisioni ka filluar të pranojë dhe të merret me trajtimin e kërkesave të para të parashtruara për kompensim. Është proceduar **Kodi i ri për të mitur në Kosovë**, i cili ne mes tjerash është zgjeruar numri i parimeve garantuese të mbrojtjes dhe respektimit të të drejtave të fëmijëve, si dhe numri i parimeve themelore, të cilat institucionet duhet t'i respektojnë dhe të kenë në konsideratë në veprimet të cilat ato i kanë në relacion me fëmijët. Vlen të theksohet që janë bërë analizat e para për hartimin e **Kodit të parë Civil në Republikën e Kosovës** dhe është filluar me punën konkrete në hartimin e Kapitujve ose librave siç do të quhen të këtij Kodi.

Kodi Civil do definojë marrëdhëniet e fushës civile dhe që do të gjejë zbatim në praktikën juridike të vendit.

Sa i përket **çështjeve pronësore**, obligim ky që rrjedh nga Titulli i pestë i MSA- së, kemi hartuar dhe Qeveria (më 18 janar 2017) e ka Aprovuar Strategjinë Nacionale për rregullimin e Çështjeve Pronësore, qëllimi i së cilës është krijimi i politikave të sektorit të të drejtave pronësore, identifikimi i fushave në të cilat reformat janë të nevojshme dhe do të shërbej si udhëzues për institucionet për të përmirësuar sektorin e pronave. Lidhur me këtë, kemi përgatitur draftin e Koncept- dokumentit për pronësinë dhe të drejtat e tjera sendore. Lidhur me **profesionet e lira ligjore**, vlen të theksohet që

ndërmjetësimi, si institucion i ri në Kosovë, është duke pasur ndikim pozitiv në zgjidhjen e lëndëve. Kjo mund të vërehet në numrin e lëndëve gjithmonë në rritje të cilat referohen për ndërmjetësim, ndërsa norma e lartë e çështjeve të zgjidhura me ndërmjetësim mbi 80%, nga ato të referuara, është ajo e cila e dëshmon vlerën e performancës së arritur në këtë fushë.

Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe Konfiskuar (AAPSK), ka rritur në masë të konsiderueshme menaxhimin e aseteve të cilat i administron, dhe e njëjtat vazhdon të punoj në ngritjen e kapaciteteve. Ministria e Drejtësisë është duke u angazhuar vazhdimisht në drejtim të ndërtimit të kapaciteteve të brendshme të AAPSK-së përmes trajnimeve intensive, të cilat kanë përmirësuar dukshëm profesionalizmin e stafit, si dhe procedurat standarde të operimit. AAPSK tanimë ka bazën e të dhënave e cila i mundëson agjencisë menaxhim më të mirë të pasurisë, si dhe afrimin më të shpejtë e të saktë të të dhënave. Rrjeti i ndër-agjencive të vendeve të Ballkanit për Rikthimin e Pasurisë - (BARIN), para disa javësh, ka mbajtur takimin e tyre të dytë në Prishtinë me temën: “Menaxhimi Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara”.

MD ka hartuar dhe Qeveria ka Aprovuar **Strategjinë Kombëtare për Mbrojtje nga Dhuna në Familje**, e cila ka për qëllim të konsolidojë bashkëveprimin mes aktorëve duke: (a) fuqizuar mekanizmat ekzistues dhe themeluar mekanizma të rinj për reagim të shpejtë për mbrojtjen dhe trajtimin e rasteve të dhunës në familje etj.

Kryetarja theksoi se duke pas parasysh njërën prej sfidave kryesore në Kosovë që është sundimi i ligjit cilat do të jenë prioritetet kyçe, pasi që numri i lëndëve të pa zgjidhura është njëra prej sfidave që po përsëritet vazhdimisht dhe a mendoni se legjislacioni do të ndryshojë dhe do të ketë trajtim më të shpejtë të lëndëve në gjykata, po ashtu edhe kriter tjetër kyç që na është përmendur jashtë kriterit të demarkacionit është çështja e luftimit të korrupsionit dhe krimit të organizuar, sa do të arrijmë që në këtë drejtim të orientohejmë pak më shumë dhe cila do të jetë njëra prej top prioritetëve në luftimin e krimit dhe korrupsionit që ju si ministër e keni paraparë në agjendën e re të Ministrisë së drejtësisë.

Milaim Zeka tha se do të dëshironte që në Kodin e ardhshëm penal të futet dëshmia, sepse deri më sot që 16 vjet nuk është dënuar asnjë dëshmitar i rrejshëm në Kosovë, mbi dëshmi të rrejshme janë dënuar me dhjetëra e dhjetëra njerëz të pa fajshëm dhe janë akuzuar deputetë, gjykatës, prokurorë etj.

Burimi i informacionit mbi të cilin po shpifin gazetarët duhet të rregullohet me Kodin penal në bazë të eksperiencës së vendeve perëndimore, ku burimi i informacionit të gazetarit duhet të tregohet para gjykatës, e jo para policisë dhe prokurorisë dhe kjo të kthehet në Kodin penal, sepse heqja e dy neneve, që u çuan një pjesë e gazetarëve u nda në dysh, unë e kam mbrojtur mos heqjen e shpifjes, ndërsa një pjesë e gazetarëve e kanë mbrojtur dhe duke i imagjinuar gjërat që po shpifin kundër çdo personaliteti.

Lidhur me ushtrimin e veprimtarive ilegale tha se në Kosovë sot janë 400 portale të pa regjistruara dhe këto për 24 orë shpifin dhe akuzojnë denigrojnë dhe na shkatërrojnë familjet.

Te deklarimi i pasurisë tha se në vendet perëndimore është i mbyllur vetëm për gjykata, polici dhe prokurori, ku keni parë që të publikohet se sa para i kam në konto dhe sa kam pasuri, kjo është rrezikim i jetës së njerëzve.

Në fund kërkoi që të adaptohen ligjet në bazë të rrethanave dhe mentalitetit ku ne jetojmë.

Ministri në përgjigjen e tij tha se sa i përket prioritete të MD, objektivë e jona është fuqizimi i sundimit të ligjit në Kosovë dhe në këtë drejtim në bashkëpunim me ministrin e Financave plotësohen kërkesat e institucioneve gjyqësore dhe prokuroriale që ndërlidhen me çështjet financiare që ka të bëjë me staf shtesë, angazhim shtesë të prokurorëve dhe stafit mbështetës, ky ka qenë një hap i rëndësishëm në përmbushjen e kapaciteteve në kuadër të pushtetit gjyqësor që të kemi kapacitete të mjaftueshme për eliminimin e zvarritjes së zgjidhjes së lëndëve.

Ne, si ministri, jemi përgjegjës për hartimin e politikave dhe ligjeve që ndërlidhen në fushën e drejtësisë, jam i angazhuar në plotësim- ndryshim të legjisllacionit që lidhet me fushën penale dhe po insisto që deri në fund të muajit nëntor të arrij ta procedojë Kodin penal dhe në 3 mujorin e vitit të ardhshëm do ta dërgojë edhe kodin e procedurës penale.

Lidhur me çështjet që i ngriti Milaimi, ai tha se me tepër i mora si sugjerime, kurse sa i përket çështjes së shpifjeve edhe sot Kosova ka bazë ligjore, ndoshta kemi nevojë me tepër në fuqizim të zbatimit të ligjeve, në këtë rast të policisë, prokurorisë dhe gjyqësorit.

Ahmet Isufi vlerësoi se Ministria e Drejtësisë duhet më së shumti të angazhohet në dy segmente, sepse vërejtjet më të mëdha po bëhen në rend dhe ligj. Lidhur me afatet, ai tha se duhet t'i përmbaheni sepse edhe në të kaluarën deklaratimet për afate gjithmonë janë prolonguar, dokumentet kanë mbetur të njëjta nuk janë bërë ndryshimet e nevojshme në ligjet që u përmenden këtu, prandaj afateve t'ju përmbaheni sepse ka shumë rëndësi që të kemi ligje më efikase e sidomos në përcjelljen në zbatimin e tyre. Specifikat janë të Kosovës, por edhe modelet e mira kur hyjnë në përdorim munden me qenë ligje të aplikueshme, e sidomos përcjellja e zbatimit të tyre.

Ilir Deda në diskutimin e tij u përqendrua në dy çështje;

E para kishte të bëjë me Ligjin për kompetencat e zgjeruara për konfiskimin e pasurisë së fituar me vepër penale, lidhur me këtë kërkoi nga ministri të merren parasysh rekomandimet e Komisionit për Integritet Evropian nga viti i kaluar, që ka të bëjë me barrën e provës që bie mbi palën e dyshuar gjatë fazës së hetimeve. Ne, si Komision, gjatë monitorimit në zbatimin e këtij ligji në vitin 2015, të gjitha institucionet relevante kanë kërkuar këtë dhe kjo është praktika që mundet me e fuqizuar Kosovën në drejtim të luftimit të korrupsionit dhe krimit të organizuar.

Pasi ky rekomandim është miratuar në Kuvendin e Kosovës është obligim për Qeverinë.

E dyta ka të bëjë me ligjin e ri për prokurorin e shtetit, andaj tha se kisha dashtë të jeni të vëmendshëm sepse nuk mund të hiqet kufizimi i pagës bazë, i cili është në versionin aktual të draftit të projektligjit, sepse BE-ja e ka kërkuar vendosjen e këtij kufizimi! Ne nuk mund të vendosim standard të dyfishtë, një për prokuror, e një për gjyqtar.

Ministri tha se sa i përket barrës së provës, a do të shkojmë më atë, që barra e provës të bjerë pa vepër penale dhe prokurori të ketë të drejtë për hetim, apo të shkojmë me atë që barra e provës të bjerë pas një procesi gjyqësor, por nëse fillohet të hetohet një proces i pasurisë pa vepër penale mendoj se është shkelje e të drejtave të njeriut, por nëse ka vepra penale atëherë barra e provës bie mbi të dyshuarin dhe këtë formë aktualisht e kemi në ligjin për kompetencat e zgjeruara për prokurorët dhe gjyqtarët,

lidhur me dëshminë për përfitimin e pasurisë në mënyrë të pa ligjshme, këtë çështje jemi duke e diskutuar dhe jam shumë i interesuar që të arrijmë të ndërtojmë mekanizma që do të jenë efikas në luftën e korrupsionit, si dhe parandalimin e rasteve të mëtejme. Pa dyshim që do t'i marr parasysh rekomandimet e Komisionit Evropian sepse ne po synojmë ta harmonizojmë legjislacionin tonë drejt integritetit në BE dhe NATO, si dhe do t'i marrë parasysh edhe rekomandimet e Kuvendit dhe do të jenë pjesë e punës sime, por ende nuk e kemi një qëndrim të qartë, por unë e favorizoj që barra e provës të bjerë mbi të akuzuarin.

Ilir Deda ndërhyri dhe tha se Kuvendi ka sugjeruar që gjatë fazës së hetimeve barra e provës të bjerë mbi të dyshuarin.

Armend Zemaj theksoi se si deputetë të Kuvendit të Kosovës jemi të obliguar t'i shikojmë njëherë propozimet mbi të gjitha të kontribuojmë aq sa kemi mundësi në rishikimin funksional të sistemit të drejtësisë. Ne duhet të jemi më konkret dhe më konciz në atë që kërkojmë dhe si dëshirojmë të avancojmë në këtë proces, ajo çka është shqetësuese për mua jo vetëm tash, por edhe në të kaluarën është vullneti politik që veprat korruptuese, keqpërdorimet e detyrës zyrtare dhe luftimi i dukurive negative në vend nuk është çështje vetëm e legjislacionit, por mbi të gjitha është e individëve që bartin pozita publike, si dhe ata që janë në sistemin e tërësishëm të drejtësisë.

Sa i përket pjesës së integriteteve, Kuvendi i Kosovës gjithmonë ka punuar në harmoni me Komisionin Evropian, ne duhet të koncentrohemi në pikat e ndryshimit dhe të njoftohet Kuvendi se çka synoni ju me ndryshuar, por personalisht e shoh mungesë synimin e juaj me atë se çka po ndodh, lidhur me koncept dokumentin për ngritje të aktakuzave ai tha se ju keni në Qeveri dhe në organet qeveritare njerëz që kanë aktakuzat për korrupsion dhe tash nuk e di qysh do ta aprovoni këtë dokument dhe t'ia sillni Kuvendit që të bëhet pjesë e ligjit, se pari duhet të nisët nga vetvetja dhe pastaj të shpërndahet nëpër dikastere, por këtë e shoh sfiduese, nëse mund të arrihet. Unë e përkrahi me gjithë kapacitetin që e kam edhe në mandatin e deputetit.

Kurse çështja e dytë të Projektligji për parandalimin e konfliktit të interesit të personat publik, këtu është me tepër çështje zhurme që bëhet se sa që janë diçka konkrete, pjesa më e ndjeshme është pjesa e luftimit të korrupsionit dhe ajo që ndërlidhet me Ligjin për konfiskimin e pasurisë të fituar në mënyrë të pa ligjshme.

Kurse lidhur me Ligjin për kompetenca të zgjeruara shtoj se sot edhe 100 vite nëse merremi me të, ju garantoj se nuk do të ketë efekt edhe nëse pjesa që po e kërkon Kuvendi, por barra e provës gjatë hetuesisë, në këtë formë se si është me kompetenca të zgjeruara nuk do të ketë efekt, sepse ne kemi nevojë për një Ligj i cili flet në tërësi për konfiskimin e pasurisë së fituar në mënyrë të pa ligjshme edhe që bie edhe te pjesa e administrimit që mundet shumë lehtë me u harmonizuar me të, deri sa nuk ka një ligj të tillë në të gjitha institucionet e vendit nuk mund të avancojmë në këtë drejtim. Në vazhdim theksoi se lidhur me çështjen e prokurorisë së shtetit që pretendon të bëni, mendoj se këtu do të keni nevojë në të ardhmen e afërt bashkërisht me të gjithë aktorët që dalin nga e kaluara e imponuar nga sistemi i UNMIK-ut dhe që është bartë në vazhdimësi Këshilli prokurorial dhe Këshilli gjyqësor të marrin praktikën e vendeve të

avancuara sepse vetëm në këtë mënyrë do t'i ndihmoni reformimit të sistemit të drejtësisë.

Në fund të diskutimit kërkoj nga ministri që t'ju japin prioritet parandalimit dhe luftimit e trafikimit me qenie njerëzore, si dhe dhunës në familje, këto dy çështje mbesin anash jo për shkak të mentalitetit, por për shkak të strukturës ligjore dhe mungesës së mekanizmave funksional për me i krye këto detyra.

Zenun Pajaziti theksoi se në përgjithësi procesi integrimi duhet me u trajtuar me seriozitet, që sfidat që po përsëriten në Raportin e progresit, shpresoj që mos të na përsëriten më. Te konfiskimi i pasurisë ju thatë se nuk ka rezultat, sidomos te kompetencat e shtuara, andaj pyetja është pse ka ardhur deri te mos implementimi i atij ligji, a është problemi në mos koordinimin e institucioneve të sundimit të ligjit, si dhe a ka një analizë në raport me këtë sfidë të përsëritur disa herë nga institucionet e BE-së.

Milaim Zeka tha se prapë po vij te sugjerimi, sepse e para, ne, si deputetë të Parlamentit të Kosovës, nuk jemi deputetë, nëse Ministria e Drejtësisë përmes ligjit nuk na bënë një mbrojtje neve. Ne si deputetë për momentin nuk kemi asnjë lloj imuniteti. Andaj duhet pasur kujdes në dy çështje:

Lidhur me hetimet e heshtura shtoj se në vendet e ndryshme evropiane zhvillojnë hetime të heshtura, ndaj njerëzve publikë, qoftë politikanëve apo gazetarëve dhe tek kur përfundojnë këto pa sukses njoftohet personi në fjalë.

Te çështja e ndëshkueshmërisë besoj që është në kompetencën tuaj, ku p.sh. te Prokuroria Speciale ku të gjithë qytetarët e kanë pasur të drejtuar mendjen se do të bëjë diçka, prokurori Ali Rexha del dhe akuzon prokurorët e Prokurorisë Speciale se po ngacmojnë gratë e huaja dhe kjo është shumë alarmante! Ministria e Drejtësisë duhet urgjentisht të mblidhet dhe të del me deklaratë dhe të bëjë diçka, pastaj Enver Hasani akuzon kryeprokurorin e shtetit se ka falsifikuar të gjitha provimet, kjo është alarmante dhe ne momentin kur është zgjedhur kryeprokuror z. Lumezi ka dalë në media se është hetuar për korrupsion dhe organizim të vrasjeve. Tani pyetja është se çka do të ndërmarrë Ministria e Drejtësisë për t'i frenuar këto gjëra sepse ka humbur besimi i qytetarëve në sistemin e drejtësisë dhe i imi personalisht.

Ministri Tahiri duke u përgjigjur në pyetjet e parashtruara tha se për këto pika që u përmenden mund të debatojmë me orë të tëra, sepse është e pa mundur që për një orë me i përmbledhur të gjitha bashkë, por po ju sugjeroj që tashmë po fillojmë me një rishikim të sektorit të drejtësisë në tërësi dhe ky proces nuk do të jetë i lehtë dhe pres që pas 16 muajve do të kemi grupet punuese që do të dalin me rekomandime të qarta se si do të procedojmë me tutje dhe ky proces mund të kërkojë edhe ndryshime kushtetuese dhe kërkoj një konsensus nacional të të gjithëve që të ulemi dhe të jemi pjesë e këtij procesi dhe të arrijmë t'ia paraqesim Kuvendit të Kosovës konkluzionet të cilat do ta fuqizojnë sistemin e drejtësisë në Kosovë.

Sa i përket Kodit penal dhe Kodit të procedurës penale jemi duke i bërë ndryshimet që ndërliken me efikasitetin e prokurorisë dhe gjykatave në luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit.

Kurse lidhur me suspendimin e zyrtarëve publikë që janë nën hetime dhe aktakuza, shtoj se ne shpesh jemi ballafaquar me vendime të gjykatave të cilat na pëlqyen apo jo duhet me u zbatuar ku njerëzit me aktakuza dhe nën hetime me vendime të gjykatës janë kthyer në vendet e punës deri në verdiktin final, andaj ky koncept dokument e qartëson këtë çështje.

Te çështja e llogaridhënies së gjyqësorit ai tha se kjo çështje do të rregullohet se jemi aktualisht duke punuar dhe deri në fund të vitit do ta përcjellim në Kuvend Ligjin për përgjegjësi disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve, sepse pas shumë ankesave të qytetarëve të Kosovës për stërzvarritje të proceseve të lëndëve asnjë gjyqtar dhe prokuror për shkak të performancës së dobët nuk është larguar. Ky Projektligj i jep mundësi edhe ministrit edhe Avokatit të Popullit të paraqesë ankesë në Gjykata Supreme kur konsiderohet se po bëhet shkelje, kjo çështje po rregullohet dhe kjo do të ndikojë në rritjen e llogaridhënies së prokurorëve dhe gjyqtarëve.

Pasi sot e patëm kohën e limituar jam i gatshëm që në një të ardhme të afërt të diskutojmë edhe për Ligjin për gjykatat, Ligjin për Këshillin prokurorial dhe Ligjin për Këshillin gjyqësor dhe të gjitha çështjet që ndërlidhen me këtë proces.

Kryetarja e falënderoi ministrin për raportim.

3. Të ndryshme

Lidhur me këtë pikë nuk kishte diskutues, andaj kryetarja e mbylli mbledhjen.

Mbledhja përfundoi në orën 11.10.

Përgatitur nga:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryetare e komisionit,

Znj. Blerta Deliu-Kodra